



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT
DIBËR**

Adresa : Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, Tel & Fax ++355(0) 218 223 24 www.qarkudiber.gov.al

**RREGULLORE
E
FUNKSIONIMIT
TË
KËSHILLIT TË QARKUT
DIBËR**

Miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 05, date 24.10.2019

P E R M B L E D H J E

<i>Kreu I</i>	<i>Dispozita te pergjithshme</i>	<i>fq.3</i>
<i>Kreu II</i>	<i>Selia e mbledhjeve</i>	<i>fq.4</i>
<i>Kreu III</i>	<i>Perberja, krijimi, menyra e organizimit, kompetencat dhe detyrat e Keshillit te Qarkut</i>	<i>fq.4</i>
<i>Kreu IV</i>	<i>Kryesia e Keshillit te Qarkut</i>	<i>fq.8</i>
<i>Kreu V</i>	<i>Kryetari i Keshillit te Qarkut</i>	<i>fq.10</i>
<i>Kreu VI</i>	<i>Sekretari i Keshillit te Qarkut</i>	<i>fq.10</i>
<i>Kreu VII</i>	<i>Komisionet e Keshillit te Qarkut</i>	<i>fq.11</i>
<i>Kreu VIII</i>	<i>Te drejtat e keshilltarit</i>	<i>fq.13</i>
<i>Kreu IX</i>	<i>Nisma ligjore per marrjen e vendimeve</i>	<i>fq.15</i>
<i>Kreu X</i>	<i>Marredheniet e Keshillit me administraten</i>	<i>fq.17</i>
<i>Kreu XI</i>	<i>Mbledhjet e Keshillit te Qarkut</i>	<i>fq.17</i>
<i>Kreu XII</i>	<i>Disiplina e mbledhjeve</i>	<i>fq.20</i>
<i>Kreu XIII</i>	<i>Votimi</i>	<i>fq.21</i>
<i>Kreu XIV</i>	<i>Dispozita perfundimtare</i>	<i>fq.25</i>

Kreu I

Dispozita te pergjithshme

Neni 1

Qellimi

Hartimi i kesaj rregulloreje ka per qellim percaktimin e rregullave te funksionimit te Keshillit te Qarkut Diber ne permbushje te misionit te tij mbeshtetur ne Kushtetuten e RSH dhe Ligjin nr.139/2015, date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Kjo rregullore percakton rregullat per organizimin e mbledhjeve, administrimin e dokumentacionit, funksionimin e komisioneve dhe procedurave te tjera per menaxhimin e veprimtarise se Keshillit te Qarkut.

Neni 2

Baza ligjore

Miratimi i rregullores mbeshtetet ne germen "a" te nenit 77 te Ligjit nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore".

Neni 3

Keshilli i Qarkut Diber organizon dhe realizon veprimtarine e tij ne baze te Kushtetutes se Republikës se Shqipërisë, ne Ligjin nr.139/2015, date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore", i ndryshuar dhe ne perputhje me rregulloren e miratuar prej tij.

Kur gjate zhvillimit te mbledhjes se Keshillit te Qarkut krijohen situata qe nuk jane te parashikuara ne ligj, akte nenligjore dhe ne kete rregullore, vendimi merret me shumice te thjeshte votash te kuorumit te siguruar ne keshill, me propozim te Kryetarit te Keshillit te Qarkut.

Neni 4

Funksionet e qarkut

(Neni 13 i Ligjit nr.8652)

1. Funksionet e qarkut jane ndertimi dhe zbatimi i politikave rajonale, harmonizimi i tyre me politikat shtetërore, ne nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj.
2. Qarku ushtron te gjitha funksionet qe i delegohen nga një ose më shumë bashki brenda territorit të qarkut, sipas një marrëveshjeje të lidhur midis palëve.
3. Qarku kryen dhe ushtron kompetencat e deleguara nga pushteti qendror, sipas parimeve të parashikuara në nenin 22 të Ligjit "Per veteqeverisjen vendore".

Kreu II**Neni 5****Selia e mbledhjeve**

Mbledhjet e Këshillit të Qarkut zhvillohen, si rregull, pranë godines se Qarkut Diber, në një sallë të posaçme. Pjesa kryesore e sallës është e destinuar për anetaret e këshillit të Qarkut, sekretarinë dhe përfaqesuesit e administrates që kanë përgatitur projektet. Një hapësirë e posaçme i rezervohet publikut, duke i siguruar atij mundësinë e plotë për të ndjekur punimet e këshillit. Një hapësirë e përcaktuar u vihet në dispozicion përfaqësuesëve të mjeteve të informacionit.

Neni 6

Kryetari i Këshillit të Qarkut me miratim të Kryesise se Keshillit të Qarkut mund të zhvendose zhvillimin e mbledhjes se Këshillit të Qarkut, përjashtimisht, në një ambient tjetër, të ndryshëm nga selia e qarkut, kur ajo bëhet e nevojshme nga papërshtatshmëria dhe jo disponibiliteti i sallës përkatëse, ose motivohet për arsye sociale dhe humane. Në këtë rast në ambientin ku do të zhvillohet mbledhja vendosen në vende të dukshme flamuri kombëtar dhe flamuri me stemen e Keshillit të Qarkut Diber.

Kreu III**PËRBËRJA, KRIJIMI, MËNYRA E ORGANIZIMIT, KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KËSHILLIT TË QARKUT****Neni 7****Perberja e Keshillit të Qarkut**

1. Këshilli i qarkut përbëhet nga përfaqësues të bashkive që bëjnë pjesë në qark.
2. Kryetarët e bashkive, që bëjnë pjesë në qark, janë kurdoherë anëtarë të këshillit të qarkut.
3. Numri i anëtarëve të Këshillit të Qarkut Diber është 17 (shtatembedhjete), kater prej te cileve jane kryetaret e bashkive qe perfshihen ne qark dhe 13 (trembedhjete) te zgjedhur nga keshillat e bashkive; Diber (4 perfaqesues), Bulqize (3 perfaqesues), Klos (3 perfaqesues) dhe Mat (3 perfaqesues).
4. **Funksioni i anëtarit të këshillit të qarkut është i papajtueshëm me çdo funksion në administratën e qarkut.**

Neni 8**Mandati i këshilltarit të qarkut**

(Neni 75 i Ligjit nr.139/2015)

1. Mandatin e këshilltarit të qarkut e fitojnë të gjithë kryetarët e bashkive përbërëse të tij, menjëherë me marrjen e mandatit përkatës.

2. Zgjedhja e anëtarëve të këshillit të qarkut përfaqësues nga radhët e këshillit bashkiak, bëhet me votimin e listes shumëmemërore të kandidatëve dhe shpallen fitues kandidati ose kandidatët që kanë marrë me shumë vota.
3. Anëtarit të këshillit të qarkut i mbaron mandati kur:
 - a) Jep doreheqjen;
 - b) Vdes;
 - c) humbet mandatin si kryetar apo këshilltar i bashkisë;
 - b) mandati i anëtarit hiqet nga këshilli bashkiak përkatës;
 - c) vërtetohet se mandati është fituar në mënyrë të paligjshme.
4. Në rastin e krijimit të vendit vakant, që lidhet me humbjen e mandatit të anëtarit të këshillit të qarkut nga një anëtar i këshillit të një bashkie, ai zëvendësohet nga këshilli bashkiak përkatës, duke respektuar ligjin për barazine gjinore.
5. Në rast se vendi vakant krijohet nga humbja e mandatit të anëtarit të këshillit të qarkut nga një kryetar bashkie në 6 muajt e fundit të mandatit, vendin e tij e zë kryetari i zgjedhur nga këshilli bashkiak përkatës.

Neni 9

Kushtet e pengesës ligjore, vetëdeklarimi dhe përjashtimi

(mbeshtetur në nenin 80 të Ligjit nr.139/2015)

1. Anëtari i këshillit të qarkut nuk përfshihet në një procedurë shqyrtimi dhe vendimmarrëse në rastet kur:
 - a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;
 - b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;
 - c) ai ose edhe personat e parashikuar në shkronjën “b”, të kësaj pike, kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në një çështje objektivisht të njëjtë dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim;
 - ç) ai ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim;
 - d) personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, kanë marrë pjesë si ekspertë përfaqësues, këshilltarë apo avokatë në çështjen në shqyrtim;
 - dh) ai ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, janë debitore ose kreditore të palëve të interesuara në çështjen në shqyrtim;
 - e) ai ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, kanë marrë dhurata nga palët përpara ose pas fillimit të procedurës së shqyrtimit;
 - ë) ai ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen, sipas rrethanave konkrete, se do

të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën në shqyrtim;

f) në çdo rast parashikohet nga legjislacioni në fuqi;

g) ai ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, janë përfshirë në çdo lloj mënyre në negocime të mundshme për punësim në të ardhmen të tij apo të personave të përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, gjatë ushtrimit të funksionit apo në negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat, pas lënies së detyrës, të kryera nga ai gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Nëse anëtari i këshillit të qarkut vëren një nga pengesat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ai njofton menjëherë me shkrim kryetarin e këshillit të qarkut.

3. Persona të tretë mund të kërkojnë përjashtimin e pjesëmarrjes së një anëtari të këshillit të qarkut nga një procedurë, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga shqyrtimi dhe vendimmarrja. Kërkesa bëhet me shkrim, i drejtohet kryetarit të këshillit të qarkut dhe përmban të gjitha provat e mundshme në të cilat ajo mbështetet.

4. Kryetari i këshillit të qarkut, i njoftuar sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, i propozon këshillit të qarkut përjashtimin ose konfirmimin e anëtarit të këshillit të qarkut nga/në procedura vendimmarrëse.

Neni 10

Funksionimi i Këshillit të Qarkut

(neni 76 i Ligjit 139/2015)

1. Këshilli i qarkut ushtron kompetencat nga çasti i konstituimit të tij deri në konstituimin e këshillit pasardhës.

2. Mbledhja e radhës e këshillit të qarkut bëhet jo më pak se një herë në tre muaj.

3. Mbledhjet zhvillohen sipas programit të punës që bën këshilli.

4. Këshilli i qarkut mbledhet jashtë radhe me kërkesë:

a) të kryetarit të tij;

b) të kryesisë së këshillit;

c) të një të tretës së anëtarëve të këshillit;

ç) të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.

5. Thirrja e mbledhjes së këshillit bëhet nga kryetari.

6. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet si rregull jo më pak se **10 ditë** para datës së zhvillimit të mbledhjes. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës.

7. Mbledhja e këshillit të qarkut quhet e vlefshme, kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 11
Detyrat dhe kompetencat e këshillit të qarkut

(neni 77 i Ligjit nr.139/2015)

Këshilli i qarkut ushtron këto kompetenca dhe detyra:

- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- b) zgjedh nga anëtarët e këshillit kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e kryesisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, dhe i shkarkon ata;
- c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit të qarkut;
- ç) miraton strukturën, organikën dhe kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së qarkut, të njësive e të institucioneve buxhetore në varësi të qarkut, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;
- dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij;
- e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
- ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm;
- f) vendos për taksat e tarifat në kompetencë të qarkut, si dhe për nivelin e tyre;
- g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
- gj) vendos për krijimin e një personi juridik me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta, sipas nenit 14 të këtij ligji;
- h) emëron dhe shkarkon drejtuesit e ndërmarrjeve dhe të institucioneve në varësi të tij; i) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
- j) vendos për vërtetimin dhe heqjen e mandatit të këshilltarit të qarkut, sipas nenit 75 të këtij ligji;
- k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin e disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik në nivel qarku;
- l) vendos për simbolet e qarkut;
- ll) jep tituj nderi dhe stimuj;
- m) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe në zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim në qark;

n) miraton ose shfuqizon vendimet e kryesisë së këshillit të qarkut.

Neni 12

Mbledhja e parë e Këshillit të Qarkut

(neni 74i Ligjit nr.139/2015)

1. Këshilli i qarkut zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se **50 ditë** nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve vendore.
2. Mbledhja e parë thirret nga **kryetari i bashkisë, qendër e qarkut**, ose nga një e treta e anëtarëve të këshillit të qarkut. Njoftimi për mbledhjen e këshillit të qarkut i dërgohet **me shkrim** të gjithë anëtarëve të këshillit të qarkut jo më vonë se **10 ditë** para datës së mbledhjes.
3. Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij.
4. Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të këshillit të qarkut, drejtohet nga anetari me i vjeter ne moshe.
5. Në mbledhjen e tij të parë këshilli i qarkut:
 - a) **zgjedh komisionin e mandateve, i cili verifikon mandatet e anëtarëve të këshillit;**
 - b) **vërteton mandatet e anëtarëve të këshillit;**
 - c) **zgjedh kryetarin, zëvendëskryetarin dhe kryesinë e këshillit të qarkut duke respektuar ligjin per barazine gjinore.**
6. Këshilli i qarkut konstituohet pas vërtetimit të mandateve të jo më pak se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.
7. Nëse nuk sigurohet pjesëmarrja e gjysmës së anëtarëve të këshillit të qarkut, mbledhja anulohet dhe thirret çdo dhjetë ditë, derisa të sigurohet shumica e nevojshme.
8. Në rast se këshilli i qarkut nuk konstituohet deri 90 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve vendore, prefekti ushtron të gjitha funksionet dhe kompetencat e këtij këshilli deri në çastin e konstituimit.

Neni 13

Zgjedhja e Kryetarit dhe zv/Kryetarit

1. Për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Qarkut bëhet propozimi i kandidaturave për kryetar me kandidatura alternative nga vetë këshilli. Zgjedhja e kryetarit të këshillit të qarkut bëhet **me votim të fshehtë**.
2. Në rastet e votimit për kryetarin, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar e votave, votimi ribëhet midis dy kandidatëve, që në raundin e pare kanë fituar numrin më të madh të votave.
3. Të njëjtat procedura ndiqen dhe në zgjedhjen e Zv.Kryetarit.

Kreu IV

Kryesia e Keshillit te Qarkut

Neni 14

Zgjedhja e Kryesise se Keshillit te Qarkut

(neni 81 i Ligjit nr.139/2015)

1. Kryesia e këshillit të qarkut përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe nga 3 deri në 5 anëtarë të tjerë.
2. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjidhen e shkarkohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Kur nuk arrihet shumica e kërkuar, kalohet në rivotim ndërmjet dy kandidatëve që kanë fituar numrin më të madh të votave në raundin e parë.
3. Anëtarët e tjerë të kryesisë së këshillit të qarkut zgjidhen dhe shkarkohen me votim, me listë shumemërore kandidatësh dhe shpallen fitues kandidatët që kanë marrë më shumë vota.
4. Kryesia e këshillit të qarkut thirret në mbledhje nga kryetari, **jo më pak se një herë në muaj**.
5. Mbledhjet e kryesisë janë të vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve.
6. Funkcionet e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të këshillit të qarkut janë të papajtueshme me funksionin e kryetarit të bashkisë.

Neni 15

Kompetencat e Kryesisë së Këshillit të Qarkut

(neni 82 i Ligjit nr.139/2015)

1. Kryesia e këshillit të qarkut ka këto kompetenca dhe detyra:
 - a) ushtron të gjitha kompetencat, me përjashtim të atyre që i janë dhënë shprehimisht këshillit të qarkut;
 - b) miraton projektaktet dhe materialet e tjera për mbledhjen e këshillit të qarkut, në përputhje me rendin e ditës, të përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme të kërkuara nga ajo vetë;
 - c) raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare, të paktën çdo 6 muaj ose më shpesh, sa herë kërkohet nga këshilli;
 - ç) raporton në këshill sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e qarkut;
 - d) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar qarkut si person juridik.
2. Në ushtrimin e kompetencave të saj, kryesia e këshillit të qarkut nxjerr vendime, të cilat miratohen nga shumica e anëtarëve të pranishëm. Vendimet marrin fuqi detyruese për t'u zbatuar nga të gjitha organet dhe personat e ngarkuar, pasi shpallen publikisht ose u bëhen të njohura subjekteve të interesuara.
3. Vendimet e kryesisë duhet të miratohen në mbledhjen më të afërt të këshillit të qarkut, në të kundërt e humbasin fuqinë e tyre që nga fillimi.

Kreu V
Neni 16
Kryetari i Këshillit të Qarkut

(neni 83 i Ligjit nr.139/2015)

1.Kryetari i këshillit të qarkut përfaqëson këshillin e qarkut në marrëdhënie me organe shtetërore, me organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, me persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, si dhe ushtron këto kompetenca:

- a) kryeson mbledhjet e këshillit të qarkut dhe të kryesisë së tij;
 - b) nënshkruan të gjitha aktet dhe procesverbalet e mbledhjeve të këshillit dhe të kryesisë së këshillit;
 - c) siguron zbatimin e vendimeve të këshillit të qarkut dhe të kryesisë së tij;
 - ç) në përputhje me tematikën e mbledhjeve të këshillit të qarkut dhe të kryesisë, përgatit raportet, projektvendimet dhe materialet e tjera të nevojshme;
 - d) drejton administratën e këshillit të qarkut dhe përgjigjet para këshillit për funksionimin e saj;
 - dh) emëron dhe shkarkon personelin e administratës së këshillit të qarkut, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;
 - e) garanton kryerjen e funksioneve që i janë dhënë me ligj këshillit të qarkut;
 - ë) merr masa dhe siguron funksionim normal të të gjitha strukturave të këshillit, të mbledhjeve të këshillit dhe të kryesisë së tij;
 - f) ushtron kompetenca të tjera, që i ngarkohen me ligj, nga këshilli i qarkut ose nga kryesia e tij.
2. Në ushtrimin e kompetencave të tij, kryetari i këshillit të qarkut nxjerr urdhra me karakter individual.
3. Në mungesë të kryetarit, funksionet e tij kryhen nga zëvendëskryetari.

Kreu VI
Neni 17
Sekretari i Këshillit të Qarkut

- 1.Sekretari i këshillit emërohet dhe shkarkohet nga këshilli qarkut, në bazë të propozimit të kryetarit të këshillit, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit. Shkarkimi i sekretarit mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të këshillit.
2. Sekretari i këshillit të qarkut është përgjegjës për:
 - a) mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit;

- b) ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve, sipas rendit të ditës;
 - c) njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit;
 - ç) shpalljen dhe publikimin e njoftimeve e të akteve të nxjerra nga këshilli i qarkut;
 - d) përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë;
 - dh) mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit.
3. Sekretari i këshillit të qarkut kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga vetë këshilli.

Kreu VII Komisionet e Këshillit të Qarkut

Neni 18

Komisionet janë organe të këshillit. Ato kryejnë funksione për njohjen e gjendjes, realizimin e iniciativës vendimmarrese dhe kontrollit në këshill. Komisionet e Këshillit janë të përhershme dhe të përkohëshme (ad-hoc).

Neni 19

Komisionet e përhershme janë të përbërë nga këshilltarë që pëfaqësohen me kriterin proporcional politik, të raportit mazhorancë – minorancë në këshill dhe janë të zgjedhur nga këshilli me votim të hapur.

Neni 20

Anëtari i këshillit të qarkut mund të bëjë pjesë **ne jo me shume se dy komisione të përhershme**. Këshilltari mund të marrë pjesë në rolin e ekspertit (specialistit), kur kërkohet nga një komision tjetër (pa të drejte vote), pa qënë anëtar i tij.

Në komisione mund të thiren edhe persona të tjerë të jashtëm si ekspert për konsultime (pa të drejte vote).

Neni 21

Në rast të dorëheqjes ose të shkarkimit të një antari të komisionit, ai zëvendësohet nga një këshilltar tjetër i të njëjtit grup politik në këshill, në mbledhje me votim të hapur.

Neni 22

Ne Këshillin e Qarkut Diber janë ngritur dhe funksionojnë keto komisione të përhershme:

1. Komisioni i mandateve.
2. Komisioni i ekonomisë dhe kontrollit të brendshëm
3. Komisioni i rendit dhe emergjencave civile.
4. Komisioni i arsimit, kultures, shëndetësisë dhe shërbimeve publike.
5. Komisioni i administrimit të territorit, bujqësisë, ujerave dhe pyjeve.

6. Komisioni i verifikimit te proces verbaleve te mbledhjes se Keshillit.
7. Komisioni i votimit dhe rregullores.

Çdo komision ka ne perberje 3 (tre) anetare.

Neni 23

Kryetari ose Zv.Kryetari i Këshillit të Qarkut me iniciativën e vetë mbledhin komisionet e përhershme. Gjithashtu komisionet mund të mblidhen dhe me kërkesën e **2/3 të anëtarëve të komisionit.**

Neni 24

Në mbledhjet e komisioneve mund të marrin pjesë edhe këshilltarë që nuk janë anëtar komisioni (pa te drejte vote). Gjithashtu dhe Kryetari ose Zv.Kryetari i Këshillit të qarkut merr pjesë në mbledhjet e komisioneve, kur e gjejnë të nevojshme për vlerësime të çështjeve të veçanta (pa të drejtë vote).

Neni 25

Komisionet e përhershme vlerësojnë projekt-vendimet që i paraqiten Këshillit të Qarkut për miratim. Ata diskutojnë dhe hartojnë raportin mbi mendimin e tyre për projekt-vendimet e paraqitura dhe i propozojnë Kryesise se Këshillit pranimin, rrëzimin, plotësimin ose ndryshimin e projekt vendimeve.

Neni 26

Komisionet e përhershme shqyrtojnë raporte, studiojnë dhe analizojnë efektivitetin e akteve normative të Këshillit të Qarkut dhe kontrollojnë zbatimin e tyre.

Nëpunësit e Administratës së Qarkut janë të detyruar te vene ne dispozicion të gjitha të dhënat dokumentare që kërkohen nga komisionet, me perjashtim te atyre te dhenave te parashikuar ndryshe me ligj.

Neni 27

Drejtorja/Spektori që paraqet projekt-aktin në këshill merr pjesë në mbledhjet e komisioneve, në kohën e shqyrtimit të tyre, duke caktuar përfaqësuesit e vet, të cilët japin sqarimet e nevojshme. **Pjesmarrja e tyre është e detyruar.**

Neni 28

Në komisione vendimet si rregull merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e komisionit dhe me votim të hapur. Mbledhjet janë të vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve.

Neni 29

Komisionet e përhershme mund të organizojnë mbledhje të përbashkëta dhe të drejtohen me konsensus nga kryetari i një prej komisioneve.

Në mbledhjet e përbashkëta çdo komision merr në mënyrë të pavarur vendime për çështjet e shqyrtuara dhe në juridiksion të tij.

Neni 30

Për çdo akt apo projekt të veçantë që shqyrton komisioni, bën raportin e vet dhe ja paraqet Kryesise se Këshillit të Qarkut. Raportimi para këshillit bëhet nga drejtuesi i komisionit ose një anëtar i komisionit që përcaktohet nga komisioni me propozim të drejtuesit të tij.

Neni 31

Në mbledhjet e komisioneve të përhershme mbahet protokolli dhe firmoset nga Kryetari dhe në mungesë nga Zv.Kryetari, i cili ka drejtuar mbledhjen e komisionit.

Neni 32

Komisionet e përkohshme formohen për studimin apo përgatitjen e një projekt-vendimi të caktuar.

Komisionet AD-HOC ngrihen për të kontrolluar dhe vlerësuar zbatimin e vendimeve të Këshillit të Qarkut si dhe veprimtari të veçanta me interes publik të Administratës së Qarkut. Ata hartojne raporte për çështje konkrete dhe i paraqesin në këshill për vlerësim dhe vendimmarrje.

Neni 33

Mënyra e krijimit dhe e funksionimit të komisioneve të përkohshme dhe AD-HOC është e njëjtë me ato të komisioneve të përhershëm.

Kreu VIII Te drejtat e keshilltarit

Neni 34

1. Këshilltari nuk përgjigjet për mendime të shprehura, lidhur me çështje zyrtare gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Me kërkesën e tij, këshilltari informohet dhe i vihet në dispozicion në çdo kohë nga administrata e qarkut, çdo lloj dokumentacioni për njohje të problemeve të juridiksionit të saj, përjashtim bejne rastet e parashikuara ndryshe ne ligj.

3. Këshilltari ka të drejtën e kualifikimit profesional, sipas programit të miratuar nga këshilli. Financimi për këto raste bëhet sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.

4. Keshilltari, pese dite para dates se zhvillimit te mbledhjes se keshillit, ka te drejten te terheqe prane sekretarit te keshillit te gjithë dokumentacionin e projekt vendimeve qe jane perfshire ne rendin e dites.

Neni 35

Këshilltarët kanë të drejtën e iniciativës së përfshirjes së çdo çështjeje, që ata mendojnë të shqyrtohet dhe të vendimohet në Këshill.

Ata ushtrojnë të drejtën e prezantimit të projekt-vendimeve dhe amendamenteve të tyre mbi çështjet e rendit të ditës, në mbledhjen e Këshillit

të Qarkut. **Amendamentet** janë propozime për korrektimin e formës, rregullimin tërësor ose ndryshime dhe plotësime të pjeshme të tekstit të projekt-vendimeve, para se për ta të vendimohet nga Këshilli.

Neni 36

Këshilltarët kanë të drejtën e përgatitjes dhe paraqitjes së pyetësorëve, kërkesës së interpelancave dhe mocioneve mbi çështje që lidhen drejtpërdrejtë me kryerjen e funksionit.

Pyetësorët, interpelencat dhe mocionet që i adresohen Keshillit të Qarkut përgatiten me shkrim dhe firmosen nga hartuesit e tyre (te pakten 1/3 e numrit të përgjithshëm të keshilltareve).

Në Rendin e Ditës së mbledhjes së Këshillit përfshihen ata pyetësorë, interpelanca dhe mocione që protokollohen në Zyrën Protokoll-Arkivit të Qarkut dhe miratohen nga Kryesia e Keshillit të Qarkut.

Neni 37

Pyetësori është kërkesa e këshilltarit, grup këshilltarësh dhe grup politik këshilltarësh drejtuar Kryetarit të Keshillit të Qarkut, për të marrë informacionin përkatës për gjendje të krijuara nga drejtimi dhe administrimi i shërbimeve publike, që lidhen me ushtrimin e funksioneve të kryetarit dhe administratës. Pyetësori është formulim i një ose disa pyetjeve, përgjigja e të cilave jepet me shkrim dhe verbalisht nga kryetari ose i autorizuari prej tij, në mbledhjen plenare të Këshillit. Pyetjet duhet të jenë të formuluar qartë dhe në mënyrë të përmbledhur.

Pyetjet lexohen në mbledhjen e Këshillit nga një këshilltar që ka firmosur pyetësorin. Kryetari ose personi i autorizuar ju përgjigjet pyetjeve, sipas rendit të tyre. Procesi ezaurohet pa debat.

Neni 38

Interpelanca është kërkesa me shkrim e një grup këshilltarësh (te pakten 1/3 e numrit të përgjithshëm të keshilltareve) drejtuar Kryetarit të Keshillit të Qarkut për t'u informuar prej tij për zbatimin e Vendimmarrjeve të Këshillit të Qarkut.

Interpelanca mund të tjetërsohet në **mocion**, kur ka arsye të faktuara ose konstatohet gjatë dhënies së interpelancës në këshill, mungesë përgjegjësie në kryerjen e detyrave dhe kompetencave të Kryetarit, zv/Kryetarit, drejtuesve të ndermarrjes së vartësive ose sekretarit të keshillit. Interpelanca kthehet në mocion vetëm atëherë kur Këshilli nga vlerësimi i interpelancës vendos, organizon dhe zhvillon debat mbi objektin e interpelancës. Në këtë rast Këshilli merr vendim mbi mocionin e ngritur.

Neni 39

Mocioni është një propozim konkret me shkrim i një grup këshilltarësh ose grup politik këshilltarësh, mbi çështje të drejtimit dhe administrimit të Keshillit të Qarkut, i argumentuar ligjërisht, për vendimmarrje në Këshill.

Mocioni është i vlefshëm kur firmoset nga te pakten **1/3** e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve dhe miratohet me debat me **50% + 1** të votave të numërit të përgjithshëm të këshilltarëve.

Neni 40

Këshilltari ka të drejtën e replikës. **Replika** është një qëndrim i paraqitur shkurt për përmbajtjen e një diskutimi të përfunduar. **Replika** bëhet menjëherë pas diskutimit dhe nuk mund të vazhdoj **më shumë se 2 minuta**.

Për të njëjtin diskutim nuk mund të bëhen më shumë se dy replika. Pas replikave këshilltari që ka diskutuar ka të drejtën e përgjigjes **deri 2 minuta**.

Neni 41

E drejta për të krijuar grupime

Këshilltarët mund të formojnë grupe në përputhje me përkatësinë partiake apo orientimeve të tyre politike.

Grupe këshilltarësh në bazë të interesave lokale, etnike, fetare nuk mund të formohen. Secili grup këshilltarësh është i përbërë nga jo më pak se **tre këshilltarë**.

Vetë grupet e këshilltarëve i komunikojnë me shkrim Kryetarit të Këshillit të Qarkut përbërjen e grupit, kryetarin dhe nënkryetarin, në mbledhjen e parë, pas asaj konstituive. Grupet e këshilltarëve, ndryshimet në përbërjen e tyre dhe drejtuesëve të tyre pasqyrohen në regjistër të veçantë.

Neni 42

Çdo këshilltar mund të marrë pjesë vetëm në një grup këshilltarësh. Këshilltari që kërkon të bëjë pjesë në një grup këshilltarësh të ndryshëm nga ai i deklaruar, deklaron me shkrim dhe gojë në këshill, grupin e këshilltarëve ku ai do të aderojë dhe vendimin e pranimit të grupit përkatës.

Kryetari i grupit diskuton në emer të grupit. Ky rregull nuk kufizon të drejtën e këshilltarit për të diskutuar individualisht.

Kreu IX

Nisma ligjore për marjen e vendimeve (Paraqitja e projekt vendimeve)

Neni 43

Të drejtën e paraqitjes së projekt-vendimeve në këshillin e qarkut, e kanë: Kryetari i Këshillit të Qarkut, grupet politike të këshilltarëve, Komisionet e Përhershme të Këshillit, Këshilltari ose një grup këshilltarësh.

Projekt vendimet e propozuara nga këshilltarët do të përgatiten me asistencën e Drejtorisë/Sektorit perkates të administratës së Këshillit të Qarkut.

Neni 44

Projekt-vendimet, i paraqiten kryetarit të këshillit, nepermjet sekretarit te Keshillit, së bashku me relacionin shpjegues i cili duhet te permbaje :

- arsyetimin e hollësishëm ligjor dhe faktik të projekt-vendimit,
- mendimin e kualifikuar juridik për konformitetin e projekt-vendimit me legjislacionin në fuqi,
- rregullat e teknikës legjislative për hartimin e projekt-vendimit përkatës,
- dokumentat e nevojshëm, që lejojnë vlerësimin e domosdoshmërisë së miratimit të projekt-vendimit të propozuar,
- paraqitja e burimeve të financimit dhe të kostove të realizimit të projekt-vendimit të propozuar, nese ka,
- të dhënat e personit/ sektorit i cili do të përfaqësojë dhe do të mbrojë projekt-vendimin e propozuar në mbledhjet e komisioneve apo të këshillit,
- propozimin e afatit kur mendohet të shqyrtohet projekt- vendimi në mbledhjen e këshillit.

Relacioni shpjegues firmoset nga Personi/Pergjegjesi i sektorit qe e ka pergatitur. Ndersa projekt vendimi firmoset nga sekretari i keshillit dhe Drejtori ose Pergjegjesi i Sektorit qe ka pergaitur projekt vendimin.

Neni 45

Sekretari i këshillit të qarkut, konfirmon mbi projekt-vendim, datën e marrjes së projekt-vendimit të propozuar. Në qoftë se vërehen mungesa formale në projekt-vendimin e propozuar, atëherë sekretari i keshillit ia kthen projekt-vendimin propozueseve, me qëllim plotësimin e mungesave formale te konstatuara.

Neni 46

Sekretari i Këshillit të Qarkut pas konsultimeve me Kryetarin e Keshillit dërgon projekt-vendimin e propozuar komisionit përkatës për të dhënë mendim dhe i cakton afatin e dhënies së mendimit. Sekretari i këshillit mund t'ia paraqesi projekt-vendimin kujtdo komisioni tjetër, kur e vlerëson se përmbajtja e projekt - vendimit është kompetencë shqyrtimi e një ose më shumë komisioneve të përhershme të këshillit.

Këshilli mund të krijojë edhe komision **ad-hoc** për të dhënë mendim mbi projekt-vendimin e propozuar.

Neni 47

Sekretari i Këshillit i paraqet Kryesise se Këshillit projekt-vendimet e propozuara për miratim, mendimin e komisionit përkatës, mendimin e Kryetarit te Keshillit.

Neni 48

Kryetari i Keshillit te Qarkut vendos ne rendin e dites se mbledhjes se Keshillit ato projekt vendime qe kane marre miratimin e Kryesise se Keshillit te Qarkut.

Neni 49

Për raste emergjente (te veçanta) Kryetari ose nje grup këshilltarësh mund të paraqesin në mbledhjen e këshillit projekt-vendim, me kërkesën për miratimin e tij, gjatë të njëjtës seance të mbledhjes së këshillit.

Me kërkesë të komisionit përkatës, kryetari i keshillit vendos për pushim të seancës për një kohë jo më të gjatë se **30 minuta**, me qëllim të përgatitjes së mendimit të duhur mbi projekt-vendimin nga ana e komisionit përkatës dhe kryetarit ose zëvendësit të tij.

Mos pranimi i kërkesës për miratim nuk është i njëvlefshëm me mosmiratim të projekt-vendimit të paraqitur. Në këtë rast, projekt -vendimi vazhdon rrugën normale të shqyrtimit nëpër komisione, dhe shqyrtim e miratim në mbledhjen e rradhës së këshillit.

Kreu X**Marredheniet e Keshillit me administraten****Neni 50**

Marrëdhëniet e keshillit me administraten, mbahen dhe realizohen kryesisht nëpërmjet Kryetarit të Keshillit te Qarkut, i cili merr masat e duhura për zbatimin e vendimeve të këshillit, si dhe relaton dhe informon këshillin dhe komisionet e tij, për ecurinë e aktivitetit të administrates.

Neni 51

Kryetari dhe nëpunësit e administrates janë të detyruar të informojnë keshillin, nëse u kërkohet, për të gjitha problemet e juridiksionit dhe ti vene në dispozicion çdo lloj dokumenti për njohje, me perjashtim të atyre qe parashikohen ndryshe me ligj. Kërkesa i bëhet Kryetarit të Keshillit te Qarkut, i cili autorizon personat/sektoret përkatës për plotësimin e saj.

Kreu XI**MBLEDHJET E KËSHILLIT TË QARKUT****Neni 52**

Keshilli i Qarkut zhvillon mbledhje te hapura per publikun, zhvillon seanca keshillimi me organet perfaqesuese dhe ekzekutive te bashkive dhe me

bashkesite perkatese, si dhe respekton te drejten e publikut per tu informuar mbi vendimmarjen. Vendimet e Keshillit publikohen ne faqen zyrtare te Keshillit te Qarkut.

Njoftimi per mbledhjen e keshillit behet publik ne vende te caktuara nga keshilli, ne faqen zyrtare dhe ne media lokale. Njoftimi permban daten, vendin, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.

Neni 53

Mbledhja e keshillit drejtohet nga Kryetari ose zv/Kryetari. **Drejtuesi** deklaron hapjen e mbledhjes pasi eshte siguruar nga sekretaria qe ne salle jane te pakten 50% + 1 e numrit te pergjithshem te keshilltareve.

Drejtuesi i mbledhjes kerkon nga keshilltaret miratimin ne parim te rendit te dites.

Pas miratimit ne parim te rendit te dites kalohet ne shqyrtimin e pikes se pare te rendit te dites. Per kete qellim **drejtuesi** i mbledhjes lexon te plote piken e pare te rendit te dites dhe fton relatuesin (kryetar komisioni/nepunes i administrates) per te relatuar mbi ceshtjen e shenuar si pike e pare e rendit te dites. Gjate relatimit shprehet edhe mendimi i komisionit te perhershem ne te cilin eshte diskutuar ceshtja.

Pas relatimit te ceshtjes **drejtuesi** i mbledhjes u kalon fjalen keshilltareve per pyetje mbi ceshtjen qe shqyrtohet. Pyetjet duhet te jene te qarta, te permbledhura dhe qe lidhen drejteperdrejt me ceshtjen qe shqyrtohet. Per sejcilen pyetje drejtuesi i jep fjalen relatuesit te ceshtjes ose nje personi tjeter pergjegjes per kthimin e pergjigjes.

Me perfundimin e seances se pyetjeve dhe pergjigjeve **drejtuesi** i mbledhjes fton keshilltaret ne diskutime rreth ceshtjes qe po shqyrtohet.

E drejta e fjales per pyetje dhe diskutime kerkohet nga keshilltaret me ngritjen e dores. **Drejtuesi** i mbledhjes i kalon fjalen per diskutim keshilltarit dhe ne procesverbalin e mbledhjes shenohen vetem pyetjet dhe diskutimet e keshilltareve qe drejtuesi i mbledhjes u ka dhene fjalen.

Keshilltarit i jepet fjala jo me shume se 1 (nje) here per diskutim mbi ceshtjen qe shqyrtohet dhe diskutimi nuk mund te zgjase me shume se **5 (pese) minuta**.

Ne perfundim te diskutimeve **drejtuesi** kerkon te shprehen edhe kryetaret e grupeve te keshillit per kalimin ne votim te pikes se pare te rendit te dites.

Drejtuesi fton keshilltaret te votojne me karton ose ngritjen e dores duke iu ofruar opsionet **pro, kundra, abstenim**. Pas numrimit te votave nga sekretaria drejtuesi deklaron miratimin ose jo te ceshtjes se pikes se pare te rendit te dites.

E njejta procedure ndiqet per pikat e tjera te rendit te dites.

Neni 54

Për çështje proceduriale fjala jepet **menjëherë**. Diskutimi ne kete rast ka të bëjë me propozime për ndryshim apo plotësime në rregullin/proceduren e

zhvillimit të mbledhjes. Çështjet proceduriale paraqiten qartë, shkurt dhe pa hyrë në thelbin e problemeve që shqyrtohen.

Neni 55 **Procesverbalet e mbledhjes**

Mbledhjet e këshillit fiksohen në procesverbalin e mbledhjes. Procesverbali mbahet nga një nepunes i administratës. Procesverbali i mbledhjes duhet të përmbajë:

- Vendin, datën dhe orën e fillimit të mbledhjes.
- Llojin e mbledhjes (e radhes, jashtë radhe, emergjente, vazhduese, e hapur, e mbyllur).
- Numrin e këshilltarëve prezent dhe emrat e këshilltarëve që mungojnë.
- Emrat e këshilltarëve që marrin fjalën dhe diskutimin e përmbledhur për sejcilin. (shenohen vetëm pyetjet dhe diskutimet e këshilltarëve që u jepet fjala nga drejtuesi i mbledhjes).
- Vendimet e mara nga këshilli. Numrin e votave pro, kundër dhe abstenim për sejcilin vendim.
- Firmen e sekretarit, Drejtuesit të mbledhjes dhe këshilltarëve që vertetojnë procesverbalin (Komisioni i verifikimit të procesverbalit që përbehet nga përfaqësues të grupeve të ndryshme politike).

Neni 56 **Mbledhjet e mbyllura**

Këshilli, me kërkesë të Kryetarit ose 1/3 së këshilltarëve me miratimin shumicës së votave të numrit të përgjithshëm të anetareve, vendos për rastet kur mbledhja është e mbyllur.

Kërkesa duhet të përmbajë arsyet ligjore për zhvillimin e mbledhjes së mbyllur.

Argumentet e zhvillimit të mbledhjes së mbyllur pasqyrohen në rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit.

Neni 57

Kur në diskutimin e një çështje në mbledhjen e hapur ka vlerësime për moralitetin, aftësinë dhe sjelljen e personave, apo çështje të tjera të klasifikuara me ligj konfidenciale, Drejtuesi i mbledhjes fton këshilltarët për ndërprerjen e mbledhjes.

Të drejtën e propozimit për ndërprerjen e mbledhjes dhe zhvillimin e mbledhjes së mbyllur e ka dhe çdo këshilltar që konstaton vlerësime të tilla, gjatë shqyrtimit të çështjeve të ndryshme në mbledhjet e Këshillit. Në këtë rast Këshilli me propozimin e motivuar të **1/3 së këshilltarëve** voton me mazhorancë të thjeshtë kalimin në seancë me dyer të mbyllura për të vazhduar debatin dhe vendimuar për çështjen konkrete.

Neni 58**Mbledhjet publike**

Kur konstatohen kushte e rrethana të veçanta politiko-administrative ose motive interesash të komunitetit, Kryetari i Këshillit i kërkon Kryesise miratimin e thirrjes së mbledhjes publike të Këshillit në Selinë e Këshillit ose në një ambient tjetër publik. Kryesia miraton rendin e ditës së mbledhjeve publike.

Neni 59

Në këto mbledhje ftohen deputetë, përfaqësues të pushtetit qendrorë, përfaqësues të komunitetit të bashkive që përfshihen në Qark, përfaqësues të shoqërisë civile, të komunitetit fetar të biznesit, të sindikatave ose të tjera pale të interesuara për çështjet që do të diskutohen. Qëllimi i këtyre mbledhjeve është pjesmarrja e publikut në qeverisjen vendore.

Neni 60

Ne mbledhjet publike Kryetari i Këshillit të Qarkut drejton mbledhjen dhe garanton lirinë e shprehjes së anëtarëve të këshillit dhe të pjesmarrësve të tjerë në mbledhjen duke përcaktuar paraprakisht tematiken e çështjeve, numrin e diskutimeve, kohën e diskutimit. Gjithashtu ai siguron lirinë dhe transparencën e informacionit nëpërmjet medias vizive dhe të shkruar për publikun e gjerë. Në mbledhje të tilla nuk ka vendimmarrje të Këshillit, por vetëm identifikim dhe programim të problematikave të trajtuara të cilat do të shërbejnë Këshillit në vendimmarrje.

Kreu XII**DISIPLINA E MBLEDHJEVE****Neni 61**

Gjate zhvillimit të mbledhjes personat e jashtëm qëndrojnë në vendet e caktuara për ta dhe nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë dhe të shkelin rregullat e mbledhjes, për çfardo arsye. Nga personat e jashtëm, nepunesit e administratës, marrin fjalën me miratim të drejtuesit të mbledhjes vetëm kur u kërkohen sqarime për projekt vendimin që shqyrtohet.

Neni 62

Këshilltarët gjate diskutimit të çështjeve në mbledhjen e Këshillit kanë të drejtë të shprehin vlerësimin, kritikën dhe konsiderimin e tyre, por ata duhet të jenë të kujdesshëm në opinionet dhe qëndrimin etik të tyre.

E drejta e fjalës dhe e shprehjes ushtrohet duke përjashtuar çfardo referim të jetës private dhe cilësive personale të kujtdo, dhe në çdo rast i përmbahet kujdesit dhe respektit qytetar, pa përdorur fjalë ofenduese. Është rigorozisht e ndaluar për të gjithë këshilltarët të cenojnë personalitetin dhe individualitetin e personit në mbledhjen e Këshillit.

Neni 63

Ne rastet kur një këshilltar prish rregullin e drejtimit dhe të zhvillimit të mbledhjes së këshillit, shprehet me arrogancë dhe cënon parimet e funksionimit të Këshillit, Drejtuesi i mbledhjes i tërheq fillimisht vemendjen. Nëse këshilltari vazhdon të prishe rregullin e mbledhjes, kryetari i këshillit i jep verejtje dhe i heq të drejtën e fjalës për çështjen në diskutim.

Në qoftë se këshilltari edhe pas këtij vendimi të Drejtuesit këmbengul në qëndrimin e tij të papajtueshëm me rregullin e zhvillimit të mbledhjes së këshillit, Drejtuesi urdhëron largimin e tij nga salla e mbledhjes.

Nëse largimi i tij nuk bëhet në mënyrë të vullnetshme, Drejtuesi ndërpret zhvillimin e mëtejshëm të mbledhjes **për 30 minuta** dhe menjëherë thërret Kryetarët e Grupeve Politike të Këshilltarëve për marrjen e masave përkatëse në zgjidhjen e problemit dhe garantimin e zhvillimit normal të mbledhjes, për zbatimin e plotë të rendit të ditës.

Neni 64

Ndalohet dialogu i këshilltarëve ndërmjet tyre në mbledhjen e Këshillit. Askujt nuk i lejohe të ndërpresë fjalën e këshilltarit në mbledhjen e këshillit, me përjashtim të Drejtuesit, në rastet kur konstaton se flitet jashtë çështjes në diskutim ose perfundon koha e diskutimit për këshilltarin.

Neni 65

Ne momentin kur nga drejtuesi i mbledhjes deklarohet mbyllja e debatit dhe fillimin e procesit të votimit, asnjë këshilltar nuk ka të drejtë të kërkojë fjalën apo të ndërhyjë, deri në shpalljen e rezultatit të votimit.

Kreu XIII**VOTIMI****Neni 66**

(neni 78 i Ligjit nr.139/2015)

1. Vendimet e këshillit të qarkut merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “e”, “f”, “g”, “gj” e “ll”, të nenit 77, të këtij ligji, që kërkojnë votat e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 77, të këtij ligji.

2. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve, që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në rast se edhe pas këtij votimi kandidatët kanë numër të barabartë votash, fituesi caktohet me short.

3. Vendimet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e marrjes së tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

Neni 67

Menyrat e shprehjes së votes së këshilltarëve janë: **votim i hapur, votim me thirrje nominale dhe votim i fshehtë.**

Neni 68

Votimi i hapur realizohet me ngritje të dorës së këshilltarit **vetem** për njerën nga alternativat **“PRO”, “KUNDRA”, “ABSTENIM”**. Drejtuesi i mbledhjes i fton këshilltarët e pranishëm në mbledhje të votojnë gjithmone sipas rendit **“PRO”, “KUNDRA”** dhe **“ABSTENIM”**.

Neni 69

Verifikimi i rezultatit të votimit të hapur bëhet nga Drejtuesi i mbledhjes në bashkëpunim me Sekretarin e Këshillit. Në fund të procesit të votimit, Drejtuesi i mbledhjes shpall rezultatin e votimit.

Neni 70

Votimi i hapur mund të perseritet, nëse e kundërshton atë qoftë dhe një këshilltar i vetëm, duke argumentuar kërkesën e tij për përsëritje të votimit dhe mbështetet nga **1/3 e këshilltarëve** të pranishëm në mbledhje. Në këtë rast përsëritet votimi dhe shpallet rezultati i votimit të përsëritur. **Votimi i hapur përsëritet vetëm një herë.**

Këshilltarët që votojnë kundër vendimit ose abstenojnë, detyrimisht shkruhen nominalisht në procesverbalin e mbledhjes së Këshillit.

Neni 71

Votimi me thirrje nominale kryhet në rastet kur miratimi i projekt-vendimeve, kërkojnë shumicë të cilësuar votash të këshilltarëve.

Votimi me thirrje nominale bëhet me listë emërore të këshilltarëve. Lista bëhet në dy kopje. Njëra prej listave emërore përdoret nga Drejtuesi i mbledhjes, i cili nëpërmjet saj fton këshilltarin të votojë, dhe tjetra mbahet dhe përdoret nga Sekretari i Këshillit, i cili regjistron, kontrollon dhe numëron votat e këshilltarëve. Këshilltari voton me zë të lartë, duke shprehur vullnetin e tij **“PRO”, “KUNDRA”** ose **“ABSTENIM”** për projekt-aktin përkatës. Rezultati shpallet nga Drejtuesi i mbledhjes mbasi janë konfirmuar listat emërore të Drejtuesit të mbledhjes dhe Sekretarit të Këshillit nga vetë ata dhe komisioni i votimit.

Neni 72

Vota e shprehur sipas vullnetit alternativ të sejcilit këshilltar në votimin me thirrje nominale shënohet në procesverbalin e mbledhjes, në momentin e votimit të këshilltarit.

Neni 73

Votimi i fshehtë perdoret në rastet kur Këshilli duhet të shprehet me votë për vlerësimin e cilësive morale, aftësive profesionale dhe qëndrimeve etike të individëve të cilet emerohen ose shkarkohen.

Për organizimin e procesit të votimit të fshehtë angazhohet Komisioni i Votimit.

Komisioni i votimit përgjigjet për zbatimin e procedurave të votimit të fshehtë. Ai (komisioni) përgatit listen e keshilltareve, fletët e votimit, kutine e votimit, dhomën e fshehtë dhe vendet e vendosjes se tyre si dhe të Komisionit të Votimit.

Neni 74

Fletët e votimit miratohen nga Komisioni i Votimit, dhe janë të barabarta në formë, ngjyrë, madhësi dhe përmbajtje. Ato përmbajnë detyrimisht stemën e Republikës dhe emertimin “Keshilli i Qarkut Diber” dhe nenshkrimet e anetareve te komisionit.

Neni 75

Votimi kryehet sipas listës emërore. Këshilltari pasi paraqet dokumentin e identifikimit, firmos në listen emerore dhe terheq fleten e votimit.

Këshilltari është **i detyruar** të shprehe vullnetin e tij në dhomën e fshehtë dhe pastaj fletën e votimit të palosur ta hedhe në kutinë e votimit.

Gjatë procesit të votimit është e ndaluar rreptësisht fotografimi, filmimi dhe rregjistrimi i votës me aparate fotografike, filmike (celularë, kamera etj.) ose me çdo mjet tjetër që realizon procese të tilla.

Neni 76

Është i ndaluar kategorikisht votimi në mënyrë të hapur dhe jashtë dhomës së fshehtë. Në rast se Komisioni i Votimit konstaton shkelje të tilla, nuk e lejon këshilltarin të hedhë votën në kutinë e votimit, i merr fletën e votimit dhe e shpall atë të pavlefshme. Në këtë rast komisioni i votimit e fton këshilltarin të votoje edhe një herë.

Në rast se këshilltari gabon në mënyrë të pavetedijshme gjate votimit (në vendosjen gabim të shenjave të votimit apo dëmtimin e saj), atij i jepet vetëm një mundësi tjetër (një fletë votimi tjetër) për të votuar.

Neni 77

Në rast se gjatë procesit të votimit këshilltari votues vepron me dhunë në shkelje të kësaj rregulloreje, komisioni ndërpret procesin e votimit dhe zbatimin e procedurave të tij dhe fton Këshillin për vendimmarrje, për vazhdueshmërinë ose shpalljen e pavlefshmërisë së votimit.

Neni 78

Gjatë procesit të votimit këshilltarët dhe personat e tjere te pranishem, e kanë të ndaluar të ndërhyjnë në punët e komisionit të votimit si dhe të çënojnë fshehtësinë e votës.

Neni 79

Komisioni i Votimit harton procesverbalin për procesin e votimit. Në procesverbal pasqyrohen numri i këshilltareve që moren pjesë në votim, numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti, rregullsia e tyre, numri i fletëve të votimit të vlefshme, numri i votave që ka marrë secili kandidat/alternative dhe rezultati i votimit (shpallja e fituesit).

Kryetari i Komisionit të Votimit lexon procesverbalin e hartuar nga komisioni për njohjen e këshilltareve me rezultatin e votimit.

Në rastin kur asnjëri nga kandidatet/alternativat nuk kanë siguruar numrin e mjaftueshëm të votave, votimi përsëritet me dy kandidatet/alternativat që në votimin e parë kanë marrë numrin më të madh të votave.

Në qofte se edhe pas votimit të dytë (balotazhit) rezultati është i barabartë, atëherë fituesi përcaktohet me short.

Neni 80

Fleta e votimit është e vlefshme kur:

1. Votohet për një kandidat ose për një numër kandidatësh ose alternativash që janë përcaktuar me parë.
2. Shenjat “x” ose “+” janë të vendosura brenda kuadrantit përkatës të fletës së votimit.
3. Fleta e votimit ka formën, ngjyrën, përmbajtjen dhe madhësinë që ka vendosur komisioni dhe nuk ka shënja dalluese që çënojnë fshehtësinë e votës.
4. Është e firmosur nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Votimit.
5. Fleta e votimit gjendet brenda kutisë së votimit.

Neni 81**Pavlefshmëria e procesit të votimit**

Pavlefshmëria e procesit të votimit shpallet nga komisioni i votimit kur:

1. Votohet hapur si individ ose në grup në mënyrë të përsëritur dhe hidhen këto fletvotimi me forcë në kutinë e votimit.
2. Dëmtohet apo thyhet kutia e votimit.
3. Dëmtohen në masë fletët e votimit.
4. Konstatohet se në kutinë e votimit janë hedhur fletë – votimi jo origjinale, të pa miratuara nga komisioni i votimit ose më shumë flete votimi se numri gjithsej i këshilltarëve që kanë marrë pjesë në procesin e votimit, sipas listës emërore të këshilltarëve dhe mandateve të tyre.
5. Përdoren akte dhune në procesin e votimit dhe hedhja e fletëve të votimit në kutinë e votimit bëhet pa mbikqyrjen dhe administrimin e procesit të votimit nga komisioni i votimit.

Neni 82

Fletët e votimit dhe i gjithë dokumentacioni i procesit të votimit të fshehtë ruhen dhe administrohen në zyrën e sekretarisë dhe të protokoll-

arshivës. Verifikimi dhe kontrolli i tyre bëhet vetëm me urdhër me shkrim të Kryetarit të Këshillit dhe në prezencë të Komisionit të Votimit.

Neni 83

Ankimi mbi rezultatin e shpallur të votimit bëhet, nga individët konkurrues ose palët e interesuara që janë pjesë përbërëse e Këshillit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tirane.

**KAPITULLI XIV
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Neni 84

Kjo rregullore miratohet me **50 % + 1** të votave të numërit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit të Qarkut.

Neni 85

Rregullorja e Funkcionimit të Këshillit të Qarkut Diber hyn në fuqi **10 ditë** pas shpalljes së Vendimit të Këshillit për miratimin e saj.

Neni 86

Rregullorja e mëparshme e Këshillit të Qarkut Diber shfuqizohet.

Neni 87

Përsa nuk shprehet në këtë rregullore, si rast përjashtues, Këshilli i Qarkut gezon të drejtën e vendimmarrjes.

Miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut Diber Nr. 05, datë 24.10.2019

K R Y E T A R

Valentina Haliti